

# LegalNews

**SPECIAL**

June 2021  
Qershor 2021



## **NDRYSHIME DHE SHTESA TË RËNDËSISHME NË LIGJIN PËR GJYKIMIN ADMINISTRATIV**

Në vazhden e ndryshimeve që prekën rregullat e procedurave gjyqësore në Republikën e Shqipërisë, më 29 maj 2021 hynë në fuqi edhe ndryshimet dhe shtesat më të fundit në lidhje me procedurat e gjykimit administrativ, të parashikuara në Ligjin nr. 49, datë 23.03.2021 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar*", botuar me Fletoren Zyrtare nr. 71 të datës 14 maj 2021.

Ndërhyrjet e kryera nëpërmjet këtyre ndryshimeve ligjore vijnë kryesisht si rrjedhojë e nevojës për të balancuar ngarkesën e punës së gjykatave dhe lehtësimin e punës së gjyqtarëve, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe efektshmërisë në administrimin e drejtësisë.<sup>1</sup>

Më së shumti këto ndryshime prekin aspekte të shqyrtimit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë, si për shembull:

- Përbërja e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe trupës gjyqësore;
- Përmbajtja dhe paraqitja e rekursit;
- Shqyrtimi dhe plotësimi i të metave të rekursit;
- Gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë;
- Publikimi i vendimit;
- Gjykimi për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore;
- Rregullime të periudhës tranzitore

Përmbajtja e këtyre risive ligjore është përmbledhtazi si më poshtë:

### **a. Përbërja e trupit gjyqës në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë**

Nëpërmjet ndryshimeve në ligjin për gjykimin administrativ është përcaktuar qartë se si rregull Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i gjykon çështjet me 3 (tre) gjyqtarë dhe përjashtimisht me trup gjyqësor të përbërë nga 5 (pesë) gjyqtarë gjykon:

- Rekursitet ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit që ka shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ; dhe
- Gjykimet për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

### **b. Përmbajtja dhe paraqitja e rekursit**

Risia e këtyre parashikimeve ligjore përshin edhe shtimin e një neni të posaçëm mbi përmbajtjen e rekursit, i cili duhet të përmbajë:

- Palët ndërgjyqëse;
- Vendimin që kundërshtohet;
- Paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;
- Shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, si dhe argumentet që

<sup>1</sup> Relacioni shoqëruar i projektligjit depozituar në Kuvendin e Shqipërisë nga nismëtarët;

mbështesin pretendimin që ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve ligjore të nenit 58;

- Prokurën e avokatit që përfaqëson palën (pra, prokura paraqitet në çdo rast, edhe kur rezulton më herët në dosjen e gjykimit).

Palët mund të paraqesin rekursin edhe në përputhje me formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Në këtë kuptim, ky parashikim ligjor unifikon kriteret e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, për të qartësuar edhe me tej këtë pikë.

Një ndryshim shumë i rëndësishëm konsiston në gjykatën kompetente ku do të depozitohet rekursi. Tanimë gjykata kompetente nuk është më ajo e shkallës së parë, por gjykata që ka dhënë vendimin (kryesisht Gjykata Administrative e Apelit), e cila pasi shqyrton përmbushjen e kriterëve formale vendos kalimin e dosjes në Gjykatën e Lartë.<sup>2</sup>

### **c. Shqyrtimi i kërkesave formale dhe të metave të rekursit**

Njësoj sikurse edhe me ndryshimet në Kodin e Procedurave Civile, ndryshimet në ligjin për gjykimin administrativ synojnë t'i japin fund problematikave të hasura për shkak të paqartësive në parashikimet ligjore mbi autoritetin dhe procedurën e shqyrtimit të përmbushjes së kërkesave formale apo të metave të rekursit.

Shqyrtimi do të kryhet fillimisht nga relatori i çështjes ose gjyqtari i vetëm në Gjykatën Administrative të Apelit-ose-gjyqtari që ka dhënë vendimin, i cili nëse rekursi ka të meta njofton palën për plotësimin e tyre brenda 5 (pesë) ditëve. Kur ankuesi nuk plotëson të metat rekursi do të konsiderohet se nuk është paraqitur dhe do t'i kthehet palës së bashku me aktet e tjera; kundër vendimit të gjyqtarit për kthimin e padisë lejohet rekurs i veçantë. Nga ana tjetër, nëse të metat plotësohen brenda këtij afati, rekursi do të konsiderohet i paraqitur që nga data e depozitimit fillestar në gjykatë.

Në rast se gjyqtari i apelit nuk ka konstatuar të metat, këtë mund ta bëjë relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet një procedure të njëjtë sikurse ajo që kryen gjyqtari i apelit.

### **ç. Njoftimi për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi**

Ndryshimet e reja kanë shkurtuar afatin e njoftimit me shpallje nga ana e sekretarisë së Gjykatës së Lartë të datës, orës dhe trupit gjykues nga 21 (njëzet e një) ditë që ishte më herët në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë tanimë.

### **d. Kalimi në seancë gjyqësore me praninë e palëve**

Formulimi i parashikimeve ligjore në lidhje me rastet për të cilat gjykata në dhomë këshillimi vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve ka ndryshuar dhe tanimë konsiston në këto raste:

- Rekursi është paraqitur ndaj një vendimi të apelit administrativ që ka gjykuar mbi aktin nënligjor normativ;
- Çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose

<sup>2</sup> [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Llojet\\_e\\_rekurseve\\_9969\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Llojet_e_rekurseve_9969_1.php)

zhvillimin e praktikës gjyqësore;

- Vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Administrativ thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës dhe kompleksitetit të çështjes kur 1) vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil/praktika e njësuar e Kolegjeve të Bashkuara dhe kur 2) ka shkelje të rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit/procedurës së gjykimit.

#### **dh. Afati për gjykimin e vendimeve mbi aktin nënligjor normativ**

Për shkak të rëndësisë së posaçme, ndryshimet e reja parashikojnë se Gjykata e Lartë duhet të kryejë shqyrtimin dhe gjykimin e rekurseve ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit mbi ligjshmërinë e aktit normativ nënligjor në 45 (dyzet e pesë) ditë nga data e marrjes së rekursit dhe jo në 90 (nëntëdhjetë) ditë sikurse është afati standard.

Në çdo rast vendimi i Gjykatës së Lartë mbi shfuqizimin e aktit nënligjor normativ duhet të publikohet i plotë në të njëjtën mënyrë që parashikohet për botimin e aktit.

#### **e. Vendimmarrja e Gjykatës së Lartë**

Njësoj sikurse ndryshimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile mbi vendimet e marra të Kolegjit Civil, tanimë Kolegji Administrativ mund të disponojë në njërin nga këto mënyra:

- Mospranimin e rekursit, në raste kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit për gjykimin administrativ;
- Prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- Prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;
- Prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës të shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit;
- Prishjen e vendimit të gjykatës të shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes;
- Ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes, kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo provave të çështjes.

#### **ë. Gjykimi për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore**

Edhe në ligjin për gjykimin administrativ janë parashikuar ndryshime të reja që qartësojnë procedurat për gjykimin e njësimin ose ndryshimit të praktikës gjyqësore.

Procedura për njësimin e praktikës gjyqësore vendoset nga Kolegji Administrativ kryesisht ose me kërkesë të palëve. Ndërsa, procedura për ndryshimin e praktikës

gjqësore mund të vihet në lëvizje si nga Kolegji Administrativ, ashtu edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Kolegji Administrativ ose Kryetari i Gjykatës së Lartë përcaktojnë me vendim të ndërmjet çështjen që shtrohet për njësim apo praktikën që shqyrtohet për t'u ndryshuar.

Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore kryhet nga Kolegji Administrativ me trup gjykues të përbërë nga 5 (pesë) gjyqtarë, në të cilin marrin pjesë trupi gjykues që po shqyrton rekursin dhe dy gjyqtarë të zgjedhur me short; ndërsa gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore zhvillohet nga kolegjet e bashkuara sipas rregullave përkatëse dhe me pjesëmarrjen e të paktën 2/3 e të gjithë anëtarëve.

Një risi interesante e ndryshimeve të reja lidhet me mundësinë që gjatë gjykimit për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, për shkak të interesit madhor të këtyre gjykimeve, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendim me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë, që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Këto mendime nuk janë detyruese për gjykatën dhe do të publikohen sidoqoftë në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

Në përfundim të këtyre procedurave, kur gjykata vendos për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendimin e saj duhet të formulojë edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm për gjykatat e tjera në lidhje me çështjet e ngjashme.

#### **f. Shqyrtimi dhe plotësimin e të metave të ankimit**

Krahas ndryshimeve dhe shtesave të lidhura me aspektet e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, një risi tjetër e përfshirë në këto ndryshime lidhet me mundësinë që relatori i Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë dhe të njoftojë palën për plotësimin e të metave të ankimit në rastin kur gjyqtari i vetëm i shkallës së parë nuk e ka kryer këtë.

#### **g. Dispozita kalimtare**

Në dispozitat kalimtare të ligjit ndryshues përcaktohet epërsia e rregullave të këtij ligji në lidhje me përbërjen e trupave gjykues dhe procedurës së gjykimit në Gjykatën e Lartë përkundrejt parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. Gjithashtu, nëpërmjet këtyre dispozitave kalimtare sqarohet dhe qartësohet se, në respektim të parimit të sigurisë juridike, rekursitet e paraqitura por ende të pashqyrtuara, do të vlerësohen për sa i përket pranueshmërisë së tyre në raport me parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services  
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",  
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7  
1010, Tirana, Albania  
Mob: +355 68 60 33 116  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Sabina Lalaj**

Local Legal Partner  
Deloitte Legal sh.p.k

Rr. "Faik Konica",  
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7  
1010, Tirana, Albania  
Mobile: + 355 68 37 33 130  
E-mail: [slalaj@deloitteCE.com](mailto:slalaj@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.